

20160712034

LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI HOTELIERE

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari hoteliere (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 62/2004, 89/2008, 115/10, 53/11, 141/12, 164/13, 187/13, 166/14, 199, 129/15, 192/15 dhe 39/16), neni 46 ndryshohet si vijon:

“Me kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe dispozita tjera, në një objekti nën kulm të përbashkët mund t’u lëshohen leje për kryerjen e veprimtarisë hoteliere më shumë personave fizikë, me ç’rast një person i njëjtë fizik mund të:

1) Marrë me qira banesa për pushim dhe dhoma në ndërtesa kolektive banesore, pronari i të cilave është bartës i së drejtës së shfrytëzimit, me ç’rast personi mund të marrë më shumë se një leje për kryerjen e veprimtarisë hoteliere, por me këtë rast numri i përgjithshëm i banesave për pushim dhe dhoma në të cilët kryen veprimtari hoteliere në bazë të të gjitha aktvendimeve të lëshuara një personi të njëjtë të mos i tejkalojë 10 dhoma ose 20 shtretër.

2) Marrë me qira shtëpi, apartamente dhe dhoma për pushim në objekte individuale banesore pronar i të cilës është bartës i të drejtës së shfrytëzimit, me ç’rast në një objekt individual banesor nën kulm të përbashkët mund të lëshohen më shumë se një leje, por me këtë rast numri i përgjithshëm i apartamenteve dhe dhomave për pushim në të gjithë objektin në bazë të të gjithë aktvendimeve të lëshuara për kryerjen e veprimtarisë hoteliere të mos i tejkalojë 10 dhoma ose 20 shtretër.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.